



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 479 Prot

Vlorë më 03/04/2024

VENDIM

Nr. 1 datë 26/03/2024

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK 2023

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës mbi realizimin e buxhetit të vitit 2023, në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 44 i Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 09, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 01, datë 10.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023"

VENDOSI :

Të miratojë buxhetin faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023 në lekë si vijon

1. TË ARDHURA

183,690,031

Nga këto :

• Të ardhura të trashguara viti 2022	40,352,638
• Grant i trashëguar nga viti 2022	51,665,562
• Të ardhura të realizuara viti 2023	16,223,312
• Grant i pakushtëzuar viti 2023	53,515,642
• Të ardhura jashtë limitit trashëguar	218,680
• Të deleguara (Kadastra)	8,723,000
• Grant i kushtëzuar Shërbimi për kujdesit social Q. Vatra	9,499,501
• Te ardhura kap 2	3,491,696

2. SHPENZIME

108,716,419

Nga këto :

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

● Aparati	94,758,461
● Të deleguara (Kadastra)	5,413,340
● Grant i kushtëzuar Shërbimi Përkujd. Sociale Q. Vatra	8,544,618

3. Të ardhura sipas pikes 1 dhe Shpenzimet sipas pikes 2 janë të pasqyruara në raportin bashkëlidhur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori : Financë / Buxhet – Sherbime.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 78 pika 3

KRYETAR

ERVIS MOÇKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot., datë ____ . ____ 2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**RAPORT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT
VITI 2023**

Buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë viti 2023 është produkt i zbatimit të politikave të përcaktuara nga Këshilli I Qarkut, në sistemin fiskal dhe atë menaxhimit të shpenzimeve, për të ofruar shërbime në standarte sa më të larta.

Ky dokument paraqet detajet e punës së administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë, si dhe arritjet e saj, gjatë vitit 2023. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet gjatë vitit, në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve, si pjesë e rëndësishme e objektivave të ndërmarra gjatë vitit 2023.

NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR MBI PROFILIN E QARKUT VLORË

Qarku i Vlorës është një ndër qarqet me shtrirje gjeografike më të madhe të vendit i cili përfshin tre rrethe, atë të Vlorës, Sarandës dhe Delvinës, me një sipërfaqe prej 2706 km², me popullsi sipas gjendjes civile 380.184 dhe me popullsi rezidente 188.795 banorë, kufiri tokësor 54 km, gjatësia bregdetare 244 km, të përbërë prej 7 njësi vendore (Bashki).

CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë në plotësim të funksioneve të veta ligjore që janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave të zhvillimit rajonal, harmonizimi i tyre me politika shtetërore në nivel qarku, si dhe cdo funksion tjetër i dhënë me ligj, ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisë qendrore dhe njësisve të qeverisjes vendore. Këshilli i Qarkut Vlorë:

- Ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë komuniteteve, ofron mundësi që reflektojnë çfarë është më e mira për këtë gjeneratë dhe për gjeneratat e ardhshme.
- Ofron bashkëpunim me njësitë vendore për bashkëfinancime në projekte gjithpërfshirëse, si ato për ndërtimin e një infrastrukture sipas standarteve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj dhe të shtrirë në të gjithë territorin nën administrim etj.
- Garanton vetëqeverisjen vendore në përputhje me parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

- Synon plotësimin sa më të mire të nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të zhvillimit të tyre.

OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023

Një ndër objektivat kryesore është pjesëmarrja e Këshillit të Qarkut Vlorë në projekte, studime e investime konkrete për hartimin e politikave të zhvillimit të rajonit dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel Qarku.

Rritjen e të ardhurave të brendshme dhe përpjekjet për thithjen e kontributeve të ndryshme kryesisht nga donatorët, kontributi i njësive të qeverisjes vendore (Bashkitë) me kuotën e tyre vjetore është një tjetër objektivi i institucionit të Këshillit të Qarkut për vitin 2023.

Duke u bazuar në pikën 3, të nenit 38 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar kuota e anëtarësisë në vlerë, ose detyrim që duhet të derdhë çdo Bashki në qarkun e Vlorës për vitin 2023, do të jetë sipas parashikimeve të këtyre njësive në buxhetet e tyre vjetore dhe të miratuara në këshillat e tyre bashkiake.

Të ardhurat që i vihen Këshillit të Qarkut Vlorë në dispozicion krijojnë mundësi më të mëdha për të financuar projekte, studime dhe investime të ndryshme në njësitë e qeverisjes vendore të Qarkut dhe i jep kryesisht prioritet njësive të cilat kanë burime të ardhurash më të pakta. Më poshtë janë listuar objektivat madhore të Këshillit të Qarkut Vlorë:

- Hartimi i Planit Sektorial për krijimin e një platforme dhe të drejtimeve strategjike të detyrueshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Vlorë;
- Krijimi i partneriteteve për zhvillim të qëndrueshëm rajonal;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndër-bashkiak dhe ndër-rajonal;
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara publikut dhe sigurimi i një qeverisje më të mirë;
- Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit Europian.

Disa nga parimet themelore në zbatimin e këtij buxheti

- Ka qënë i balancuar dhe transparent
- Zbatimi i Buxhetit të vitit 2023, është realizuar duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, konkretisht në Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2023". Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” .

- Buxheti është i balancuar pa deficit ose suficit (të ardhurat janë të barabarta me shpenzimet).
- Të ardhurat e arkëtuara dhe shpenzimet e kryera raportohen në mënyrë periodike dhe transparente ndaj institucioneve të tjera publike dhe në mbledhjen e këshillit. Shpenzimet janë prokuruar sipas akteve ligjore në fuqi.

- I besueshëm

Buxheti i vitit 2023, ka qënë i planifikuar në bazë të burimeve të mundshme dhe të realizueshme të të ardhurave nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat e gjeneruara lokale. Kjo ka mundësuar realizimin e shpenzimeve në kohë sipas një programi të parashikuar për gjenerimin e të ardhurave dhe mundësive për likuiditete në çdo kohë të lindjes së këtyre shpenzimeve.

- Efiçenca dhe efektiviteti i tij

Buxheti i vitit 2023, është zbatuar duke kryer shpërndarjen më të mire të mundshme të burimeve të të ardhurave të realizuara, dhe me një tendencë në rritje drejt shpenzimeve kapitale sipas projekteve konkrete dhe atyre të mirëmbajtjes dhe të shërbimeve, duke balancuar së pari nevojat, strategjitë dhe vizionin për zhvillimin e rajonit.

Zhvillimi i mëtejshëm i legjisllacionit për pushtetin vendor, pas miratimit të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ka shënuar arritje të madhe në pajisjen e institucioneve të pushtetit vendor me autoritetin e nevojshëm, për të ushtruar funksionet e veta vendore, me instrumentat e nevojshëm për zhvillim të qëndrueshëm vendor e atë rajonal. Buxheti i vitit 2023 i institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë ka reflektuar me përpikmëri parimet dhe bazë ligjore në mbështetje të reformës territoriale.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2023, ka siguruar plotësimin e nevojave, brenda kufizimit të të ardhurave.

- Në zbatim të Ligjit 139/2015 , datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar Ligjin nr. 68 /2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, të Ligjit nr. 9936 Nr. 9936 datë 26.06.2008, “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar , të Ligjit nr.115/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”. Realizimi i detajuar i buxhetit të vitit 2023, është si më poshtë vijon:

Ky buxhet përmban fondet që ka patur në dispozicion Këshilli i Qarkut Vlorë për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-financiare vjetore të tij, burimet e financimit dhe funksionet

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

kryesore të strukturave financiare të cilat janë përshkruar si mëposhtë :

Burimet e financimit:

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare:

- a. Për funksionet e veta
- b. Për funksionet e përbashkëta
- c. Për funksionet e deleguara

Të ardhurat e vitit 2023 kanë qënë parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë në konsideratë të dhënat e ecursisë së arkëtimeve të viteve të fundit dhe realizimit faktik të vitit 2023.

Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë vitit 2023 kanë qënë si mëposhtë:

- Të ardhura që janë arkëtuar gjatë vitit 2023, nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut.
- Të ardhurat nga derdhja e kontributeve në (%) si detyrim ligjor i Bashkive në territorin në administrim të Qarkut Vlorë, të ardhura të cilat zënë një masë të konsiderueshme në këtë tregues.
- Të ardhurat të trashëguara nga viti buxhetor 2022, të cilat janë përdorur për të përballuar shpenzimet korrente dhe kapitale të këtij viti buxhetor.

VËSHTRIM I PËRGJITHËM MBI BUXHETIN E VITIT 2023

Karakteristikat kryesore të shpenzimeve dhe të ardhurave të përgjithshme të administratës së Këshillit të Qarkut të Vlorës për vitin 2023 janë:

- Realizimi në mënyrë të kënaqshme i treguesve të performancës në arkëtimin e të ardhurave nga tarifat.
- Realizimin e të ardhurave vendore, ku një peshë të rëndësishme përbën derdhja e kontributeve të njësive vendore (Bashkitë)

Këshilli i Qarkut Vlorë gjatë vitit 2023 ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara ku në vijim gjendet analiza e treguesve kryesore të shpenzimeve të krahasuara me objektivat e vendosura në fillim të vitit 2023.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Për këtë viti ushtrimor buxheti i administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë paraqitet përgjithësisht i realizuar në zërat e shpenzimeve dhe investimeve, duke ruajtur një raport të drejtë, ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke reflektuar një bilanc pozitiv të pagesave, brenda limiteve të miratuara nga Këshilli i Qarkut.

Të ardhurat

Viti 2023	në 000/ lekë		
Të ardhurat gjithsej : (1+2+3+4)	144,639,827	183,690,031	127%
Transferta e Pakushtëzuara (granti)	53,515,642	53,515,642	100%
Tarifat vendore viti 2023	13,805,250	16,223,312	123%
-Tarifat shërbimi vendore dhe të tjera	405,250	504,600	
124%			
-Kontributet nga njësitë vendore	13,400,000	15,718,712	115%
Të mbartura nga viti i kaluar	95,728,576	95,728,576	100%
-Të mbaruara nga shp. Viti kaluar (grant)	51,665,562	51,665,562	100%
-Të mbartura nga shp. Viti i kaluar (ardhura)	40,352,638	40,352,638	100%
-Të ardhura Jasht Limit (sponsor)	218,680	218,680	100%
-Të ardhura të trashëguara kap2 viti 2023	3,491,696	3,491,696	100%
Transferta e Kushtëzuar	18,222,501	18,222,501	100%
-Transferta e Kushtëzuar (DAMT)	8,723,000	8,723,000	100%
-Transf e Kushtëz (Qendra Psiko Sociale Vatra)	9,499,501	9,499,501	100%

ANALIZA E TË ARDHURAVE VITI 2023

Në të ardhurat e Këshillit të Qarkut të Vlorës përfshihen:

Të ardhurat e veta nga tarifat vendore si dhe të ardhurat nga buxheti i shtetit, fondet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara.

TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Të ardhurat vendore viti 2023, arritën shumën prej 16,223,312 në 000/lekë, planifikuar në 13,805,250 lekë, realizuar në masën 123%.

Realizimi i të ardhurave sipas parashikimeve në buxhetin e v. 2023

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

Aparati	Plan	Fakt	%
Tarifa sherbimi	405,250	504,600	124%
Kuota e antaresise	13,400,000	15,718,712	115%

TË ARDHURA NGA BUXHETI I SHTETIT

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha transferat nga buxheti i shtetit për përballimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara dhe një pjesë të funksioneve të veta dhe të përbashkëta.

TË ARDHURAT NGA FONDET E PAKUSHTËZUARA (GRANTI)

Gjatë vitit 2023, shuma totale e grantit prej 105,181,204 lekë , përbëhet nga :

- Granti i përfituar nga pushteti qendror për vitin 2023 53,515,642 lekë.
- Granti i trashëguar nga shpenzimet e vitit 2022 51,665,562 lekë

Transferata e Pakushtëzuar (granti) është e ardhura e Pushtetit Vendor , e trashëgueshme, e përfituar nga Buxheti i Shtetit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e përcaktuara si mëposhtë :

- Pagat e personelit
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit
- Për shpenzimet operative
- Janë financuar Shoqatat e të Verberve të Vlorës dhe Sarandës
- Investime

TË ARDHURAT NGA FONDET E KUSHTËZUARA

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Qarkut Vlorë për përmbushjen e funksioneve të deleguara dhe të

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

përbashkëta, ka përfituar nga buxheti i shtetit vetëm fonde buxhetore për shpenzime në shumën prej 18,222,501 lekë, (8,723,000 lekë + 9,499,501 lekë) . Ky akordim është kryer në mbështetje të programit fillestar të buxhetit dhe parashikon mbulimin vetëm të shpenzimeve për funksionet e deleguara dhe të përbashkëta (DAMT, Qendra Psiko – Sociale Vatra).

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023 NË LEKË

SHPENZIME KORRENTE

I. Realizimi i Shpenzimeve të Qarkut Vlorë për vitin 2023.

Pasqyra Nr.1

Nr	EMËRTIMI			
		Plan	Fakt	%
1	Administrata (Grant)	105,741,364	66,905,291	64%
	Paga personeli Art (600)	20,060,160	14,647,955	73%
	Sigurime Shoqërore Art (601)	3,500,000	2,450,942	70%
	Shpenzime Operative Art (602)	19,592,065	10,989,931	56%
	Transferta te brendshme (604)	4,485,192	2,713,743	60%
	Fond i vecante (609)	734,000	0	0
	Projekte (230)	14,582,677	9,314,269	64%
	Investime Art (231)	42,787,270	26,788,464	63%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Administrata (Të ardhurat)	53,752,638	27,853,170	54%
Shpenzime Operative Art (602)	4,381,665	323,055	7.4%
Transferta te brendshme (604)	8,500,000	8,500,000	100%
Transferta te jashtme (605)	400,000	321,441	81%
Fondi rezerve kontigjenca Art (609)	4,053,650	520,951	13%
Projekte (230)	36,417,323	18,708,661	52%
	18,222,501	13,957,958	77%
Transferta e Kushtëzuar (DAMT)	8,723,000	5,413,340	62%
Paga personeli Art (600)	7,200,000	4,488,528	63%
Sigurime Shoqërore Art (601)	1,223,000	734,177	60%
Shpenzime Operative Art (602)	300,000	190,635	64%
Transferte e Kushtëz (Qendra Psiko-Sociale Vatra)	9,499,501	8,662,880	91%
Paga personeli + Sigurime Shoqërore Art (606)	9,499,501	8,544,618	90%
Totali Qarku	177,716,503	108,716,419	61%

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

Analiza analitike e Shpenzimeve për vitin 2023, për (Administratën)

Shpenzimet e përgjithshme gjatë vitit 2023, vetëm për administratën e qarkut janë realizuar në shumën prej 94,758,461 mijë lekë.

SHPENZIMET KORRENTE

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administra e Këshillit të Qarkut gjatë vitit 2023.

Ky buxhet i administrates paraqitet përgjithësisht i realizuar në disa nga zërat e shpenzimeve, duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke reflektuar një bilanc pozitiv të pagesave, brënda limiteve të miratuara nga Këshilli i Qarkut për shpenzimet korrente.

Në vijim kemi paraqitur analizën e përdorimit të fondeve të ndara sipas strukturave dhe zërave të shpenzimeve dhe artikujve.

Shpenzimet korrente për Administratën e Qarkut

● **Shpenzime për Pagat dhe Shpenzimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)**

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2023 për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Duke analizuar më hollësisht kemi 13 punonjës që paguhën me Transferten e Pakushtëzuar.

Realizimi i fondit të pagave për vitin 2023, ka arritur në shumën 14,647,955 lekë, ose e shprehur në përqindje në 73%.

● **Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)**

Planifikimi i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2023, është paraqitur në shumën prej 23,973,730 lekë, me një realizim prej 11,312,986 lekë ose 48% kundrejt programit të planifikuar.

● **Shpenzimet për pagesat e Transfertave të Brendshme, TVSH projekte (Artikulli 604)**

Në këtë artikull përfshihen shpenzimet e planifikuara për transfertat e brendshme siç janë ato të Shoqatave të Verbërve të Vlorë, Sarandë, Delvinë, Shoqatës së Këshillave të Qarqeve, Transfertat për bashkitë e qarkut dhe Tvsh projekte, për vitin 2023 ishin parashikuar në vlerën 12,985,192 lekë dhe u realizua në vlerën 11,213,743 lekë, ose 92% e vlerës së parashikuar.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

● **Fondi Rezerve (Artikulli 609)**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, fondi rezerve krijohet për të përballuar shpezimet e pa parashikueshme në buxhet, masa e përcaktuar e këtij fondi është jo më shumë se 3% të shpenzimeve të programuara, ky fond për vitin 2023 ishte parashikuar në vlerën 4,787,650 leke dhe u përdor vlera 520,951 leke për paga dhe sigurime si pasojë e urdherit nr 328 për shtesën e pagave dhe sigurimeve.

● **Shpenzimet Kapitale Investimet (Artikulli 230-231)**

230 - Projektet Save Water dhe Waste React

Për këto dy projekte ishte parashikuar një fond prej 51,000,000 leke dhe u përdor në vlerën 28,022,915 leke.

231-Investimet

	Plan	Fakt
Investimet 12/ muhor viti 2023	42,787,270	26,788,464
Ndërtimi i Kullave të vrotimit në Lagunen e Nartës	2,187,270	0
Rikonstruksion i rrugëve të brendshme Novoselë , Vlorë	32,000,000	24,000,000
Rikonstruksion kopshti (Stavri Bombaj) B.Selenice	4,000,000	2,788,4640
Bashkia Delvinë, rikonstruksion i fasadës së Pallatit nr.4/18,dhe sistemim oborrit në lagjen "9Tetori"	3,000,000	0
Studim Projektim	5,000,000	0

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

- *Ndërtimin e dy kullave të vrojtimit në Lagunën e Nartës, nuk është realizuar sepse pati pengesa të gjendja juridike e pronave ku ishin parashikuar këto investime. Investimi tenderuar (Pritet leje e ndërtimit) në proces.*

II. Analiza Analitike e Shpenzimeve për vitin 2023, për (Transferten e Kushtëzuar)

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas grup artikujve përdorimin e fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), fonde të cilat Këshilli i Qarkut i ka marrë në formën e Transfertës së Kushtëzuar nga buxheti i shtetit dhe Ministrisë e linjës.

Gjatë vitit 2023, shpenzimet e përgjithshme për punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën prej 5,413,340 lekë, ndaj programit vjetor prej 8,723,000 lekë ose e shprehur në përqindje në 62%

Ky buxhet paraqitet përgjithësisht i realizuar në të gjitha zërat e shpenzimeve, fondi pagave dhe sigurimeve shoqërore parashikuar me rezerva.

Në vijim kemi paraqitur analizën e përdorimit të fondeve të ndara sipas strukturave dhe zërave të shpenzimeve dhe artikujve, ku këta të fundit janë paraqitur dhe në tabelën mëposhtë dhe në vijim një analizë e detajuar:

a. Shpenzimet për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)

Realizimi i shpenzimeve për pagat dhe sigurime shoqërore gjatë vitit 2023, për punonjësit e funksioneve të deleguara nga organet e pushtetit qendror të cilat janë ata të drejtorisë të administrimit dhe mbrojtjes së tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës, "Për buxhetin e vitit 2023".

Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2023, janë realizuar në shumën 5,222,705 lekësh, kundrejt fondit të programuar shuma prej 8,423,000 lekë, ose e shprehur në përqindje në 63%.

b. Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)

Në mbështetje, të planifikimit të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes parashikuar nga Ministria e linjës, "Për buxhetin e vitit 2023", janë realizuar në shumën 190,635 lekësh, kundrejt fondit të programuar shuma prej 300,000 lekë. Ose e shprehur në përqindje në 64%.

III. Analiza Analitike e Shpenzimeve për vitin 2023, (Qendra Psiko-Sociale Vatra)

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas grup artikujve përdorimin e fondeve për shpenzimeve që ka patur në dispozicion punonjësit e (Qendra Psiko-sociale Vatra)

Gjatë vitit 2023, shpenzimet e përgjithshme për punonjësit e Qendra Psiko-Sociale Vatra, janë realizuar në shumën prej 8,544,618 lekësh, ndaj programit vjetor prej 9,499,501 lekë ose e shprehur në përqindje në 90%.

Ky buxhet paraqitet përgjithësisht i realizuar në të gjitha zërat e shpenzimeve.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

Në vijim kemi paraqitur analizën e përdorimit të fondeve të ndara sipas strukturave dhe zërave të shpenzimeve dhe artikujve, ku këta të fundit janë paraqitur dhe në tabelën mëposhtë dhe në vijim një analizë e detajuar:

- **Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve**

Duke analizuar më hollësisht kemi: Për periudhën e 12/mujorit vitit 2023, kemi një realizim të shpenzimeve sipas numrit të punonjësve në strukturë, të planifikuar dhe realizimi i këtij numri ka qënë i njëjtë me numrin në strukturë. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në shumën 8,544,618 lekë, kundrejt fondit të programuar në shumën prej 9,499,501 lekë ose e shprehur në përqindje në 90%

Të gjitha diferencat në vlerë absolute nga planifikimi i strukturave të Transfertës së Kushtëzuar kalojnë në Buxhetin e Shtetit pasi janë vlera që nuk mbarten për vitin në vazhdim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETAR

ERVIS MOCKA

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

KËSHILLI I QARKUT VLORE

Muaji Shator - Dhjetor 2023

Dejtyrmet ndaj të tretëve sipas vlerësish së tyre, situata financiar normale dhe raste e veshtrësive financiare

N.R	Emertimi	Stoka në vlerë	Shpenzime sjelore faktike për NJVQ-në	Subsidi Shpenzime sjelore faktike të NJVQ-vë
I	Bartje (a+b)	0		
a	Itim afërgjate	0		
a.1	Mirrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdrati c/j)			
a.2	Trituj të emeluar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	Itim afërkuror	0		
b.1	Mirrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdrati c/j)			
b.2	Trituj të emeluar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Dejtyrmet e prapambetura	1,274,000		
II	Llogaritja ekonomike			0.80%
4864100	Vendime Gjyqësore			
4864200	Del. Prap. Sherbime			
4864201	D.12 Energjektivitet			
4864300	Del. Prap. Mirëmbajtje			
4864400	Del. Prap. Investime			
4864500	Del. Prap. Rimbursi, TVSH			
4864600	Maltra			
4864900	Del. Prap. Të Tjera	1,274,000		
4864601	Del. Prap. Sig. Shqiptore			
4864602	Del. Prap. Sig. Shendet			
4864603	Del. Prap. Ardh. Personal			
4864604	Del. Prap. Të Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpenzime			
4864903	Trans. Indiv.			
4864904	Trans. Subjekti			
III	Totali (I+II)	1,274,000	159,494,002	0.80%

Nëpunësi Zbatues

Anisa Hyseni

[Signature]

Nëpunësi Autorizues

Ervis Mecka

Situata Normale e gjendjes financiare	Kriteri i veshtrësive të ndodhur nësitë e veshtrësive vendore			
	Probleme financiare	Veshtrësi financiare	Veshtrësi serioz financiare	Pasigësi pasurore
Situata Normale e gjendjes financiare	Stoka i dejetimeve/Shpenzime > 15%	Stoka i dejetimeve/Shpenzime > 25%	Stoka i borxhi afatgjat dhe dejetimeve/Shpenzime > 80%	Stoka i borxhi afatgjat dhe dejetimeve/Shpenzime > 100%
Situata Normale e gjendjes financiare	0	0	0	0

M. 6.14

KESHILLI I QARKUT VLORE

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

në lekë

Nr.	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
		499,100	800,000
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	0	0
1	Taksat e veta vendore		
a.	Taksa mbi pasurinë		
b.	Biznesi i vogël		
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		
d.	Taksa të tjera vendore	499,100	800,000
2	Të ardhura jotatimore		
a.	Tarifat e shërbimeve publike	499,100	800,000
b.	Tarifa administrative		
c.	Të tjera jo tatimore	0	0
3	Taksa të ndara		
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme		
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura		
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale		
e.	Të tjera	94,184,711	159,494,002
II	Shpenzime të Buxhetit Vendor	94,184,711	159,494,002
1	Shpenzime Korrente	14,647,955	20,060,160
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	2,450,942	3,500,000
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	22,274,420	42,146,572
d.	Shpenzime Operative	54,811,394	93,787,270
e.	Të tjera korrente		
2	Shpenzime Kapitale	0	0
3	Burimet e Financimit		
a.	Të ardhurat e veta vendore		
b.	Transferta e pakushtëzuar		
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale		
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Nëpunësi Zbatues

Anisa Hyseni



Nëpunësi Autorizues

Ervis Mokka